

Akt Themelimi

I Shoqërisë " GE-D " shpk

Në TIRANË, sot më dt 05.01.2021 (pesejanardymijenjezetenjë) unë shtetasi Shqiptar:

- **Enzo Muho** , i biri i Shkëlqimit i datëlindjes 12.12.1984 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit "ID" Nr. 033038787 me numër personal I41212048L lëshuar me date 24.02.2016.
me vullnetin tim te lirë kam vendosur krijimin dhe themelimit e shoqërisë " **GE-D SH.P.K**". *mbështetur ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare "*, *ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"*.

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti, Kapitali.

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është " **GE-D** " SHPK. me qendër ne qytetin e Tiranës Rruga Frederik Shiroka, Kati 0, ish fusha e zezë.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria " **GE-D** " SHPK, është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga personi fizikë i sipërpërmendur, i cili përgjigjet për detyrimet deri ne kufirin e kapitalit themeltare te nënshkruar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë ne Rrugën Frederik Shiroka, Kati 0 Tiranë, Ish fusha e zezë dhe vulën e saje.

Shoqëria mund te ndryshoje selinë e saj, te hape zyra përfaqësie, dege, te krijojë filiale, njësi shitje si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te ortakut.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do te ushtroje aktivitet privat ne fushën e :
Projektim inzhinierie. Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të

ndërtesave të çdo lloji. Auditim energjie, konsulentë inxhinierie. Studim, mbikëqyrje, kolaudim, projektim arkitektonik, arredim, sistemime të jashtëm, rikonstruksion, restaurim, mirëmbajtje godinash, projektim dhe zbatim të rrjetit të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, akses kontroll,

sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit për objekte civile dhe industrial. Import-eksport, shitje me shumice dhe pakice të materialeve ndërtimore, elektrike, mobileve, pajisjeve të IT-se, ndriçueseve, UPS, elektro-shtepiake, materialeve hidraulike. Instalim, konfigurim, operim dhe mirëmbajtjeve të pajisjeve IT, telefoni, telekomunikacion, sigurisë së informacionit, sistemeve audio dhe video, mirëmbajtje dhe prodhim web-i. Tregtim me shumice dhe pakice të të gjithë llojeve të printerëve, serverëve dhe pajisjeve IT. Ndërtim i godinave civile deri në 5 -kate dhe mbi 5 -kate.

Punime ndërtimore për sistemet e jashtëm. Mirëmbajtjeje godinash civile, industriale, zyrash, hotelesh dhe qendrave të rekreacionit. Tregtim materiale laboratorike, formim profesional. Trajnime dhe kurse për sigurinë në punë për çdo lloj aktiviteti. Tregti me pakice të librave.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 100.000 lekë .

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin si me poshtë .

Ortaku themelues ENZO MUHO zotëron 100% të kuotave me vlerë të përgjithshme 100.000 lek që përben 100% të kapitalit të shoqërisë .

Neni 7

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga UNE Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "GE-D" SHPK, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën time origjinale bashkë me statutin e shoqërisë i dërgohen Q.K.B .për regjistrim në regjistrin tregtarë .

ORTAKU I VETEM

ENZO MUHO

